


# PJESËMARRJA AKTIVE E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJEN LOKALE

2023

Për Qytetin



## Përmbajtje

1. Çfarë kuptojmë më pjesëmarrje në vendimarrje?
  - 1.1 Mekanizmat e pjesëmarrjes së publikut në vendimarrje
  - 1.2 Shqipëria dhe pjesëmarrja e publikut në vendimarrje
2. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve në vendimarrje
  - 2.1 Peticionet dhe iniciativa qytetare
3. Perceptimi i publikut mbi peticionet dhe iniciativat qytetare drejtuar bashkive
  - 3.1 Metodologjia
  - 3.2 Analiza e gjetjeve
4. Peticionet dhe iniciativat drejtuar Bashkive Tiranë, Durrës dhe Kurbin.
5. Konkluzione dhe rekomandime

## 1. Çfarë kuptojmë më pjesëmarrje në vendimmarrje?

"E drejta e qytetarëve që të marrin pjesë në udhëheqjen e çështjeve publike", përfshirë në nivelin lokal sanksionohet në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, dhe Protokollin Shtesë në të cilin thuhet se "e drejta për të marrë pjesë në punët e një autoriteti lokal nënkupton të drejtën për të kërkuar të përcaktojë ose të ndikojë në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të një autoriteti lokal". Kur autoritetet lokale konsultojnë dhe angazhojnë qytetarët për hartimin dhe vlerësimin e shërbimeve publike, ata hapin rrugën për rezultate më të mira të politikave dhe gjithashtu për besim më të madh reciprok midis qytetarëve dhe qeverisjes.

Pjesëmarrja e qytetarëve përfshin arritjen tek një sërë palësh lokale të interesit, siç janë aktivistët e shoqërisë civile, gazetarët, anëtarët e akademisë, përfaqësuesit e biznesit, komunitetet lokale dhe qytetarët aktivë. Është e rëndësishme që ajo të jetë gjithëpërfshirëse, duke marrë parasysh pikëpamjet e publikut më të gjerë, aktorët ekspertë dhe grupet përfaqësuese, duke përfshirë të cënuarit dhe të marginalizuarit.

Për më tepër, angazhimi i palëve të interesit duhet të përfshijë arritjen tek ata, jeta dhe interesat e të cilëve do të preken nga zbatimi i vendimeve në shqyrtim. Për të siguruar që palët e interesit janë identifikuar, konsultimet publike duhet të fillojnë para se të jetë bërë një angazhim për veprim ose para se të jetë paraqitur një projekt-vendim. Një proces konsultativ më i hapur, së pari fton palët e interesit të diskutojnë dhe identifikojnë problemet, sfidat dhe mundësitë, pastaj shqyrton skenarët e ndryshëm të politikave, para se të hartohen vendimet.

### 1.1 Mekanizmat e pjesëmarrjes

Disa nga mekanizmat kryesorë të pjesëmarrjes në vendimmarrje janë:

- **Informimi i publikut** për përparësitë vendore, programet dhe planet qeveritare, nëpërmjet publikimit të programeve të detajuara të transparencës, një nivel të lartë të trajtimit të kërkesave për informacion dhe një rol proaktiv në publikimin e prokurimeve, kontratave apo punëve të ndryshme publike.
- **Mbajtja e konsultimeve** me publikun dhe/ose grupet e veçanta të njerëzve në lidhje me politikën publike dhe mbledhjen e përvojës ose ekspertizës së tyre.

- **Bashkëpunimi me qytetarët** ose grupe të veçanta njerëzish për të zhvilluar zgjidhje për problemet lokale.
- **Angazhimi i komuniteteve lokale** në proceset e vendimmarrjes përmes proceseve diskutuese, votimit (siç është buxhetimi me pjesëmarrje dhe referendumet vendore për çështje të rëndësishme), dhe mjete të tjera vendimmarrëse.

Sipas Protokollit Shtesë, "ligji siguron mjete për lehtësimin e ushtrimit" të së drejtës së qytetarëve për të marrë pjesë. Për të siguruar që format e sipërpërmendura të pjesëmarrjes janë angazhim i vërtetë dhe jo ushtrime simbolike, procesi i konsultimit rreth formimit të politikave dhe legjislacionit të ri duhet të mbështetet me ligje, rregullore dhe udhëzime, si dhe me vullnet të fortë politik. Jo më kot në vendin tonë baza ligjore me ligjin për konsultimin publik, tashmë është e shtruar, por problem mbetet ende zbatimi i tij në praktikë.

Politikëbërja përfshirëse duhet në të njëjtën kohë të jetë efektive, dhe publiku duhet të jetë i informuar mirë për të drejtat, mundësitë dhe mënyrat se si mund të marrë pjesë në vendimmarrjen lokale. Proceset e hartimit të politikave duhet të deklarohen qartë paraprakisht për t'i mundësuar qytetarëve dhe grupeve të interesit të përgatitin parashtrësat dhe ndërhyrjet e tyre. Afatet kohore me pika të qarta hyrëse për angazhimin e qytetarëve duhet të publikohen për të siguruar që pjesëmarrja e qytetarëve është një ushtrim kuptimplotë dhe autoritetet lokale duhet të japin informata kthyesë për ata që bëjnë propozime ose rekomandime politike.

Bashkitë gjithashtu duhet të punësojnë zyrtarë të trajnuar në menaxhimin e konsultimeve publike dhe të sigurojnë që informatat kthyesë ndaj qytetarëve të jenë të shpejta dhe gjithëpërfshirëse.

Qasje të tilla gjithëpërfshirëse sigurojnë që bashkitë të marrin vendime më të mira dhe më të rëndësishme që pasqyrojnë interesat publike dhe kuptohen mirë nga të gjithë qytetarët. Së bashku, komunitetet lokale mund të zhvillojnë një kapacitet të qëndrueshëm për të shprehur shqetësimet e tyre, për të hartuar zgjidhje dhe për të monitoruar zbatimin e tyre të duhur, duke rezultuar në përmirësimin e besimit të publikut ndaj ofrimit të shërbimeve lokale.

## 1.2 Shqipëria dhe pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje

Në të gjitha 61 bashkitë e vendit është në zbatim modeli i programit të transparencës i miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Pavarësisht publikimeve të programeve si model, përmbajtja e tyre lë për të dëshiruar.

Bashkitë kanë përparuar më tej në pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen lokale, veçanërisht në fushën e buxhetimit me pjesëmarrje. Megjithatë, kuadri institucional për pjesëmarrje efektive dhe gjithëpërfshirëse ka nevojë për fuqizim të mëtejshëm. Zbatimi i ligjit për konsultimin publik në nivel vendor është i pakënaqshëm. Një numër në rritje i bashkive raportojnë informacionin publik, ku 61 bashki kanë caktuar një koordinator lokal për të drejtën e informimit, por përsëri ankimimet që përcillen pranë zyrës së komisionerit janë në nivel të lartë.

Ligji i 2014 për konsultimin publik, që përcakton normat procedurale për transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, është përgjithësisht në përputhje me standardet evropiane. Sidoqoftë, fusha e zbatimit të ligjit duhet të vlejë për vendimet e qeverisë. Kjo kërkon raportim se si kontributet merren parasysh nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC), por ka pak të dhëna për përdorimin dhe efektivitetin e mekanizmave të reagimit. Nuk është bërë asnjë përparim për konsultimin publik në miratimin e akteve nënligjore dhe zbatimin e ligjeve për vullnetarizmin dhe aktivizimin shoqëror.

Në përgjithësi, Shqipëria ka një legjislacion adekuat dhe modern në shumicën e fushave, por procesi i hartimit të politikave kryhet përmes politikave me dyer të mbyllura dhe i kufizuar në një grup të ngushtë aktorësh. Prosesi i digjitalizimit të shërbimeve për të përmirësuar transparencën, llogaridhënien dhe për t'i sjellë qytetarët më pranë qeverisë, fatkeqësisht shoqërohet me mungesë shifrash dhe dokumentacion të pamjaftueshëm. Në lidhje me hartimin e politikave të hapura në nivel vendor, marrëdhënia midis qytetarëve dhe zyrtarëve publikë është pothuajse inekzistente.

Raporti i Komisionit Evropian 2021 për Shqipërinë nënvizon shqetësimet me qasjen e qeverisë ndaj pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe konsultime publike, të filla si nevoja për bashkëpunim më kuptimplotë me shoqërinë civile, reagime gjithëpërfshirëse dhe mekanizma të mëtejshëm. Raporti gjithashtu nxjerr në pah përdorimin e kufizuar të portalit të konsultimeve publike të qeverisë dhe konsultimet joefektive në sektorin privat. Pandemia e dobësoi akoma më shumë pjesëmarrjen, për shkak të distancës që duhet të mbanin qytetarët nga institucionet, dhe këto të fundit mes vete.



## 2. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve në vendimmarrje

### 2.1 Peticioni dhe iniciativa qytetare

Një nga format më sinjifikative të pjesëmarrjes aktive në qeverisjen vendore dhe atë qendrore janë peticionet dhe iniciativat e komunitetit. Peticionet publike u mundësojnë qytetarëve të ngrenë çështje pranë Këshillave Bashkiakë. Numri i nënshkrimeve të mbledhura mund të tregojë nivelin e mbështetjes për çështjet e ngritura. Ato synojnë ose të ngrenë profilin e çështjes, ose edhe të kërkojnë që të ndërmerren veprime specifike. Peticionet shpesh frymëzohen nga aktiviteti i shoqërisë civile, por ato gjithnjë e më shumë dorëzohen përmes platformave zyrtare, shpesh online, ku peticionet me një numër të caktuar nënshkrimesh, janë të destinuara të marrin një përgjigje zyrtare.

Në zbatim të nenit 19 dhe 20 të ligjit 139/2015 për vetqeverisjen vendore, Këshillat Bashkiakë kanë miratuar rregullore të posaçme për mundësimin e iniciativave dhe peticioneve vendore ndaj qytetarëve të tyre. Sipas kësaj rregulloreje peticioni është një kërkesë drejtuar Këshillit Bashkiak apo Komisionit të Përhershëm të Këshillit, për ta nxitur të ndërmarrë apo të mos ndërmarrë një veprim apo marrë vendim me interes kolektiv publik, i bërë me shkrim dhe i shoqëruar me nënshkrime nga një grup qytetarësh ose banorësh, grup organizatash apo grupe interesi, dhe që i adresohen për çështje në kompetencë ligjore të Këshillit, apo për një çështje për të cilën Këshilli ka mundësi të influencojë apo llobojë.

Objektivat që parashikon rregullorja e peticioneve dhe iniciativave për rolin e tyre janë:

- *Forcimi i demokracisë vendore,*
- *Angazhimi i qytetarëve në çështjet e politikave publike,*
- *Promovimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrjen bashkiake,*
- *Ngushtimi i distancës midis të përfaqësuarve dhe përfaqësuesve të tyre,*
- *Promovimi i transparencës në vendimmarrjen e Këshillit.*

Peticionet mund ti drejtohen organeve kolegjinale të ngritura në kuptim të ligjit siç janë:

- *Këshillit Bashkiak,*
- *Kryesisë së Fshatit,*
- *Këshillit Komunitar në Lagje.*

Peticionet elektronike zhvillohen dhe dorëzohen përmes faqes së internetit të Bashkisë, dhe respektojnë të njëjtat kërkesa dhe procedura si peticionet me letër:

- *Parashtruesit e peticionit dorëzojnë me shkrim në zyrën e protokollit të Bashkisë kërkesën për krijimin e peticionit elektronik, së bashku me të dhënat e peticionit.*
- *Për të nënshkruar peticionin elektronik mbështetësit futin në aplikacionin e peticionit të dhënat si emrin, adresën postare apo kodin postar dhe një adresë të vlefshme email-i.*
- *Nënshkruesi/ja do të marrë një email në adresën e tij/saj me anë të së cilit do të konfirmohet nëse adresa e email-it është e vlefshme.*
- *Një peticion elektronik nuk mund të zhvillohet njëkohësisht me një peticion me shkresë, ndërkohë që ata kanë të njëjtën kërkesë dhe të njëjtët organizatorë.*

### **3. Perceptimi i publikut mbi peticionet dhe iniciativat qytetare drejtuar bashkive**


#### **3.1 Metodologjia**

Qëndresa Qytetare zhvilloi një pyetësor me 600 banorë të Bashkive Tiranë, Durrës dhe Kurbin, për të matur perceptimin e qytetarëve të 3 bashkive lidhur me disponibilitetin që ata kanë për tu përfshirë në peticione dhe mundësitë që bashkia e tyre u ka vënë në dispozicion për t'u shprehur apo pyetur për aktivitetin e saj vendor.


Anketa u zhvillua online, e mbështetur nëpërmjet facebook ads dhe target komunitetin e tre bashkive të përzgjedhura, ku konkretisht u intervistuan 350 qytetarë nga bashkia Tiranë, 150 banorë të bashkisë Durrës dhe 100 të pyetur ishin rezidentë në bashkinë Kurbin. 60% e të pyeturve ishin vajza/gra dhe 40% djem/burra, ndërsa 32% e të pyeturve ishin të moshës 18 – 30 vjeç, 53% ishin të moshës 31 – 50 vjeç, ndërsa 15% ishin të grupmoshave mbi 50 vjeç.

### 3.2 Analiza e gjetjeve

Pyetjes nëse qytetarët i janë drejtuar Bashkisë/Këshillit Bashkiak me një peticion për një problematikë të komunitetit, **më shumë se gjysma (53%) e banorëve të Tiranës i janë përgjigjur pozitivisht, ndërkohë 46.2% e banorëve të Kurbinit kanë nënshkruar një peticion dhe vetëm 40.7% të banorëve të Bashkisë Durrës i janë drejtuar bashkisë së tyre me një peticion.**



Ndërkohë sipas përgjigjeve të të anketuarve, **bashkia që u është përgjigjur më shumë qytetarëve është ajo e Durrësit me 18% të kërkesave, më pas ajo e Tiranës me 17% dhe në fund bashkia e Kurbinit me 9% të kërkesave.** Qytetarët e Tiranës, janë më të predispozuar për ti kërkuar bashkisë, ndërsa Bashkia e Durrësit rezulton Bashkia më e predispozuar për t'iu përgjigjur kërkesave të banorëve të saj, megjithëse këta të fundit janë më indiferentët për t'iu drejtuar kësaj bashkie.






**79% e banorëve të tre bashkive të marra në analizë janë të gatshme të nënshkruajnë më parë një peticion online se fizik, kundrejt 21% të tyre që do të nënshkruanin një peticion/iniciativë fizike përpara atij online.** Banorët e bashkisë Durrës janë më të predispozuar për t'iu bashkuar një peticioni online me 81.4%, më pas ata të Tiranës me 78.6% dhe në fund ata të Kurbinut me 76.5%.




Banorët e tre bashkive janë skeptikë sa i përket dhënies së numrit të ID-ve për qëllime nënshkrimi peticioni apo initiative. **40% e banorëve shprehin se nuk do ta jepnin kartën e tyre të identitetit për të nënshkruar një peticion apo iniciativë, ndërsa 60% janë të gatshëm ta vendosin numrin e tyre të identitetit në peticion.** Banorët e bashkisë Durrës janë më skeptikët me 46.5% kundër dhënies së ID, ndërsa ata të bashkisë Kurbin më të gatshmit për ta përdorur ID e tyre për peticione me 76.9% pro.




Mbi 80% e banorëve që nuk i japin të dhënat e ID-së së tyre për të nënshkruar një peticion, mendojnë se nëse vendosin nr e ID-së, të dhënat e tyre do të keqpërdoren.

Sa i përket çështjeve për të cilat qytetarët do ishin gati ti drejtonin bashkive të tyre një peticion, në bashkinë Tiranë dhe Kurbin, dominon problematika e transportit publik, respektivisht **banorët e bashkisë Tiranë (20%) dhe bashkisë Kurbin (57%), ndërsa për qytetarët e Durrësit problem kryesor për të cilin do të nënshkruanin një peticion mbetet parkingu publik me 33%**. Aspekte të tjera për të cilat qytetarët janë të gatshëm ti drejtohen bashkive të tyre me peticione ose iniciativa janë ndotja, uji i pijshëm dhe trafiku.



Pas depozitimit të një peticioni apo initiative, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregulloreve të miratuara nga Këshillat Bashkiakë, këto të fundit duhet të veprojnë për të informuar qytetarët dhe adresuar çështjet që ata përcjellin. **Nga analiza rezulton se 87% e qytetarëve të cilët kanë nënshkruar një peticion, nuk janë thirrur ndonjëherë nga bashkia apo Këshilli Bashkiak në dëgjese për trajtimin e çështjes së tyre. Vetëm 8% e tyre shprehen se thjesht janë informuar nga bashkia ndërsa vetëm 5% e banorëve thonë se janë thirrur në një dëgjese nga bashkia e tyre.** Të tria bashkitë në këtë rast aplikojnë sjellje të ngjashme ndaj banorëve që i drejtohen atyre me peticion.

Sa i përket veprimit të bashkive ndaj peticioneve të qytetarëve, **vetëm 7% e të pyeturve shprehen se bashkia ka marrë masat e nevojshme për të zgjidhur problemin e adresuar me peticion, ndërsa 23% thonë se bashkia i ka informuar se do të ndërhyjë për problemin, por ndërhyrja nuk ka ndodhur ende. 70% e të pyeturve shprehen se bashkia nuk ka reaguar pas depozitimit të peticionit në Këshillin Bashkiak.**



**55% e qytetarëve të tre bashkive besojnë se Kryetari i Bashkisë është organi që u zgjidh më shpejt problemin e tyre, 27% ia besojnë hallin e tyre ndërlidhësit komunitar, ndërsa vetëm 18% besojnë se është Këshilli Bashkiak organi që mund të zgjidhë më shpejt problemet e tyre.** Qytetarët e Durrësit besojnë më shumë se ata të dy bashkive të tjera tek kryetari i bashkisë me 63%, ndërsa ata të Kurbinit kanë më shumë besim për zgjidhjen e problemit të tyre tek ndërlidhësit komunitarë me 33%.

Por kur pyetja drejtohet se cilën rrugë do të përdornin për të adresuar çështjen e tyre, **30% e banorëve të tre bashkive shprehen se do përdornin peticionin drejtuar Këshillit Bashkiak, 45% do i kërkonin një takim Kryetarit të Bashkisë, ndërsa 25% do t'i drejtonin një ankesë zyrës së bashkisë.**



30%



45%



25%

Pra, pavarësisht se besimi i qytetarëve është i ulët tek Këshilli Bashkiak, ata janë të gatshëm ti dërgojnë peticione këtij organi.

**Në dy bashkitë e mëdha, Tiranë dhe Durrës, 60% e banorëve nuk njohin asnjë prej Anëtarëve të Këshillit Bashkiak, ndërsa 35% e tyre njohin 5 deri në 10 Këshilltarë. Vetëm 5% e të pyeturve njohin më shumë se 10 Këshilltarë.** Ndryshe paraqitet situata në Bashkinë Kurbin, ku vetëm 15.4% e banorëve të pyetur nuk njohin asnjë këshilltar, kjo edhe për shkak se në bashkitë e vogla, hapësira fizike dhe sociale është e vogël dhe qytetarët kanë më shumë njohje me njeri – tjetrin.

**Kur banorët u pyetën a e njohin Kryetarin e Bashkisë së tyre, 100% e qytetarëve të Kurbinut dhe 85% e qytetarëve të bashkive Durrës dhe Tiranë pohojnë se e njohin Kryetarin e bashkisë së tyre.** Pra, jemi para faktit që kryetarët e bashkive kanë punuar më shumë për t'u ekspozuar në media dhe komunitet se këshilltarët, të cilët në një masë të madhe nuk njihen nga banorët, pavarësisht se votohen prej tyre. Kjo për shkak edhe të sistemit electoral, i cili ekspozon më tepër kryetarët e bashkive dhe i le nën hijen e partisë këshilltarët.



85%



85%



100%

## 4. Peticionet dhe iniciativat drejtuar Bashkive Tiranë, Durrës dhe Kurbin.

### 4.1 Iniciativat qytetare elektronike

Gjatë muajit dhjetor 2022 Qëndresa Qytetare në bashkëpunim me Kongresin Studentor, një organizim studentësh në nivel kombëtar, hartuan dhe ndërmorën një iniciativë qytetare drejtuar Këshillit Bashkiak Tiranë për ndërtimin e katër mensave publike në katër godinat e konvikteve të studentëve, me qëllim reduktimin e kostove të ushqimit për studentët që studiojnë në kryeqytet.

Për këtë iniciativë u mbledhën në rrugë elektronike 6620 nënshkrime, të cilat u depozituan në Këshillin Bashkiak, çështje e cila pritet të shqyrtohet prej këtij Këshilli sipas rregullores së iniciativave dhe peticioneve dhe për zbatim të nenit 20 të ligjit për vetqeverisjen vendore. Depozitimi i kësaj iniciative është rasti i parë i ndërmarrjes së kësaj procedure administrative në funksion të një komuniteti siç është ai i studentëve.





## 4.2 Iniciativë qytetare për vendosjen e transportit publik urban

Qendra Sebastia, në muajin dhjetor 2022, ndërmori një iniciativë qytetare drejtuar Këshillit Bashkiak Kurbin me kërkesë të vetme vendosjen e transportit publik për qytetarët e kësaj bashkie. Transporti publik urban në Kurbin mungon



dhe e bën më të vështirë lëvizjen mes zonave, madje edhe duke kufizuar shumë aktivitete të komunitetit qofshin ato ekonomike, social-kulturore apo dhe për shërbimet shëndetsore që u duhet të marrin larg qendrave të banimit dhe transporti është i domosdoshëm.

Transporti ndërqytetas është shumë problematik për zonat rurale, pasi komuniteti në ato zona e ka të pamundur aksesimin e qytetit në rastet kur nuk kanë mjete private, apo janë në moshë të thyer. Të vetmet mjete transporti që shfrytëzohen nga këto komunitete janë furgonat që lëvizin për nxënësit e shkollave, apo për punëtorët e fasonerive, kështu çdo banor i zonave rurale edhe kur mundet të gjejë një mjet transporti për të kryer nevojat më të nevojshme duhet të harxhojë kohë dhe energji. Iniciativa do të ketë shtrirje të gjerë, e cila do të prekë 4 njësitë administrative të Bashkisë Kurbin, pra Milot, Mamurras, Fushë-Kuqe dhe Laç. Iniciativa u mbështet nga 1% e banorëve me të drejtë vote në bashkinë e Kurbin, në rrugë elektronike dhe u dorëzua pranë zyrës së protokollit më datën 29 Dhjetor 2022.

## 4.3 Iniciativë qytetare për planifikimin dhe ndërtimin e një konvikti për studentët e UAMD.

Qendra Durrësi Aktiv ndërmori një iniciativë qytetare në bashkinë Durrës, të mbështetur nga 1% e banorëve me të drejtë vote. Sot, Universiteti "Aleksandër

Planifikimi dhe **ndërtimi** i një konvikti për studentët e Universitetit Aleksandër Moisiu, **Durrës**, i pajisur mesherbime studentore sipas standarteve bashkëkohore.

Bashkohu  
firmos  
*Peticionin*



Moisiu" ka 5 fakultete dhe numërohen rreth 20 mijë studentë në ciklet e studimit. Themelimi tij i dha zhvillim qytetit të Durrësit dhe e ktheu në një qytet universitar, por ende mungojnë konviktet dhe rezidencat me shërbime për studentët.

#### 4.4 Peticion drejtuar Këshillit Bashkiak Durrës lidhur me pastrimin nga mbetjet dhe rehabilitimin e kanalit kullues në zonën e Nishtullës, Durrës

Durrësi Aktiv facilitoi mbledhjen e 60 nënshkrimeve të banorëve të zonës së Nishtullës në Durrës, të cilët iu drejtuan Këshillit Bashkiak Durrës për shkak të mbetjeve, të cilat kishin zënë kanalën kulluese e për rrjedhojë kjo zonë rrethohej nga aroma të pakëndshme, përmbajtje në kohë shiu dhe bllokime të rrugëve kulluese.



Në datën 2 Dhjetor në këtë zonë Bashkia filloi punimet për pastrimin e kanaleve kulluese të kësaj zonë, si përgjigje ndaj peticionit të dërguar nga Durrësi Aktiv dhe banorët. Ky ishte një nga rastet kur vendimmarrësit i përgjigjen në kohë banorëve, megjithëse zona kishte nevojë edhe për ndërhyrje të tjera aftagjata rehabilituese për mospërseritjen e problemit në të ardhmen.

#### 4.5 Peticion drejtuar Këshillit Bashkiak Kurbin

Rruga që përshkon fshatin Fushë-Gjorëm, Njësia Administrative Mamurras, e cila lidh fshatin me autostradën Milot – Fushë-Krujë dhe në skajin tjetër lidhet me rrugën Laç-Mamurras. Me gjatësi rreth 3.5 km është në gjendje të



**KËRKOJMË:**

1. Sistemimin e rrugës në Fushë-Gjorëm, Njësia Administrative Mamurras.
2. Asfaltimin dhe ndricimin e saj.
3. Hapjen e kanaleve kulluese të kësaj rruge

*Firmos peticionin*

mjerueshme dhe kushtëzon jetën e banorëve në aktivitetet e tyre të përditshmërisë.

Peticioni u ngrit si rrjedhojë e nevojës emergjente të komunitetit, pasi kjo rrugë nuk shërben vetëm për të lidhur fshatin me rrugët kryesore, por lehtëson edhe aktivitetet e tyre ekonomike, kryesisht atë bujqësor, i cili është aktiviteti kyç me të cilin mbahet zona. Ky aks rrugor e vështirëson lëvizjen e qytetarëve në çdo stinë, në verë i mbyt pluhuri e në dimër balta i detyron të mos kalojnë në atë rrugë, por të mundohen të gjejnë zgjedhje alternative.

#### 4.6 Peticion: mundësimi i pagesës alternative dhe reduktimi i tarifës së parkingëve në kryeqytet

Qëndresa Qytetare facilitoi mbledhjen e rreth 600 nënshkrimeve të banorëve të kryeqytetit për një peticion drejtuar Këshillit Bashkiak, i cili konsistonte në ofrimin e mundësisë alternative të pagesës së shërbimit të parkimit, përveç asaj nëpërmjet SMS-ve; uljen e tarifës së parkimit, në një nivel të përballeshëm për qytetarët e Bashkisë Tiranë, një tarifë që bazohet tek standardi i jetesës së qytetarëve dhe mundësimi i 10 minutëshit të parë në ndalim falas për çdo qytetar të Bashkisë Tiranë.

Kërkojmë

**MUNDËSIMIN E  
PAGESËS ALTERNATIVE  
& REDUKTIMIN E TARIFËS  
SË PARKIMEVE  
NË TIRANË**

**STOP  
Gjobave**

*Firmos  
Peticionin*

## Konkluzione dhe Rekomandime

- Megjithëse rregulloret e hartuara dhe miratuara nga Këshillat Bashkiakë e parashikojnë e-peticionin dhe e-iniciativën si mekanizma pjesëmarrje, asnjë prej 61 bashkive nuk e ka ofruar këtë mundësi për banorët e saj. Sekretariatet e Këshillave Bashkiakë duhet të marrin masat për përshtatjen dhe integrimin e kësaj të drejte për qytetarët. Ndërkohë 79% e qytetarëve sipas sondazhit të Qëndresës Qytetare janë të gatshëm të nënshkruajnë një peticion elektronik përpara atij fizik.
- Nënshkrimi elektronik i ofruar nga ALEAT përmban një kosto shtesë në vlerën 6 euro/nënshkrim duke e pamundësuar nënshkrimin elektronik zyrtar si mënyrë përdorimi për iniciimin e peticioneve dhe iniciativave.
- Niveli i trajtimit të peticioneve në rrugë zyrtare, bazuar në rregullore është i ulët; Këshillat Bashkiakë ende nuk janë përshtatur administrativisht me procedurat e trajtimit të tyre e për rrjedhojë janë shfaqur mungesa të përgjigjes në afat, në përmbajtje dhe në veprime institucionale të trajtimit të peticioneve apo iniciativave.
- Vendosja e numrit të ID, si kusht për të nënshkruar një peticion në rregulloret e miratuara nga Këshillat Bashkiakë, bën që qytetarët të qëndrojnë të tërhequr ndaj bashkimit në këto peticione apo iniciativa, sidomos në këtë situatë të përhapjes së lajmeve për përdorimin e të dhënave personale. Sugjerohet që në formatin e lëshuar nga Këshillat Bashkiakë apo organizatorët e peticioneve dhe iniciativave të hiqet opsioni i numrit të ID dhe të mbahen të dhëna të tjera lehtësisht të verifikueshme si njësia, numri i telefonit apo adresa e e-mail.
- Këshillat Bashkiakë duhet të luajnë një rol më aktiv në trajtimin e problematikave të qytetarëve duke nisur nga trajtimi procedural i kërkesave apo ankesave të tyre e deri tek mbledhjet në komisionet tematike të përhershme, të cilat mund të trajtojnë dhe propozojnë çështje sipas natyrës së kërkesës në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Administrata e Këshillave Bashkiakë nevojitet të trajnohet dhe fuqizohet në këtë drejtim, për të mundësuar një respektim rigoroz të rregulloreve të peticioneve dhe iniciativave duke stimuluar kështu edhe një pjesëmarrje më të lartë dhe aktive të vetë qytetarëve.



---

# PJESËMARRJA AKTIVE E QYTETARËVE NË VENDIMMARRJEN LOKALE

Për Qytetin



Qëndresa  
Qytetare



Financuar nga Leviz Albania

LEVIZ  
Albania

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC